



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.197/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Violeta Husaj Rugova - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore, për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 28.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Komuna Pejë, Anr.197/2025 e datës 25.01.2025.
- II. Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Komuna Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 2.000,00 € (Dymijë) Euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 25.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me të cilën pretendon se nënkryetari Bashkim Krasniqi, përmes aktivistit Ardijan Krasniqi të Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), më datë. 24.01.2025, në ora 23:07, ka publikuar dhe shpërndarë një video me përmbajtje denigruese ndaj Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës –IRDK dhe kryetarit Elbert Krasniqi, ku thuhet”... po hetohet edhe ministri i MAPL, ministria e Elbert Krasniqit dyshohet se në mënyrë të kundërligjshme

ka shpenzuar rreth treqind mijë euro, për projektet që kanë të bëjnë me minoritetet”, ku të njëjtës ja kanë vendosur mbishkrimin “ Kësaj i thonë Dinjitete dhe barazi e përkushtim për komunitete” andaj krahas mbishkrimi të aktivistit të PLE-së, Ardijan Krasniqi” Ju aktivistë e dashamir të IRDK-së, çka tjetër duhet të ju dëshmojnë që jeni në rrugën e gabuar”

Më tej në ankesë thuhet se nënkryetari i Partisë Liberale Egjiptiane- PLE, Bashkim Krasniqi, nga të lartcekurat kuptohet se përmes aktivistit të PLE-së Ardijan Krasniqi , me videon e shpërndarë si dhe mbishkrimet e vendosura ka për qëllim të ndikoj në ndryshim të opinionit publik dhe nxitjen e urrejtjes ndaj Elbert Krasniqit si Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kryetar i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës. Paraqitësi i ankesës pretendon se Elbert Krasniqi asnjëherë nuk është ftuar apo njoftuar nga organet e Drejtësisë se ndaj tij është iniciuar apo ka filluar ndonjë proces hetimor dhe se lidhur me këtë çështje apo ndonjë proces edhe pse nuk ka , do të vlente prezumimi i pafajësisë dhe se nuk lejohet dëmtim i imazhit për qëllime të ulëta të kundërshtive politike. Sipas parashtruesit të ankesës, dhe sipas ligjit , përkatësisht nenin 34,paragrafi 1.11, i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovës shkelësi i supozuar, me këtë veprim ka përdorur gjuhën, në formën e shkruar duke nxitur ose provokuar, ose duke mundur të nxis a provokojë në urrejtje kundrejt te tjerëve si dhe përbëjnë veprim të ndaluar të subjekteve politike.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur dy fotografi, postin në facebook dhe një CD me videon e shpërndarë në post.

Më datë 26.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partisë Liberale Egjiptiane- (PLE) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 27.01.2025.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 27.01.2025, subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane- (PLE) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), thekson se shkrimet dhe videot janë në qarkullim për opinionin publik që një kohë të gjatë dhe nuk kanë të bëjnë fare me nxitje të urrejtjes por vetëm një pasqyrim të asaj çështje që është publikuar dhe shpërndarë nga mediat Kosovare kohë me parë dhe se për opinionin është e njohur. Në përgjigjen e tyre theksojnë se Ardian Krasniqi nuk është në listë Zgjedhore dhe i njëjti ka të drejtën e deklarimit dhe shprehjes të pakufizuar. Më tutje në përgjigjen në ankesë theksohet se ankesa është e pabazuar sepse të njëjtit nuk janë autor të video incizimit dhe nuk kanë të bëjnë fare me provokim, përdorim të gjuhës së urrejtjes por vetëm një pasqyrim i një realiteti të prezantuar nga Mediat ne Kosovë dhe se në asnjë mënyrë nuk përmbushet asnjë nga elementet e përcaktuara te nenit 34,par.1.11 te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Në përgjigjen në ankesë ritheksojnë se IRDK ka paraqitur ankesë kinse për shkelje të dispozitës të Kodit të Sjelljes për Subjekte politike me të cilën për asnjë shkelje të tillë nuk ka mundur ta prezantoj sepse nuk ka asnjë bazë juridike për shkeljen e pretenduar.

Përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur fotografi dhe linqe ku sipas tyre vërtetohet e kundërta e asaj me të cilën është paraqitur në ankesë.

Sipas përgjigjes së subjektit politik PLE, theksojnë se subjekti politik IRDK në lidhje me ankesën në fjalë e ka paraqitur që të mos e lejoj që qytetarët të jenë të informuar lidhur me zhvillimet në vend dhe nëse kjo është cenim di dispozitave të LZP, atëherë cili do të ishte

qëllimi dhe garimi në zgjedhje parlamentare. Kërkojnë nga PZAP- që ankesa në fjalë, të refuzohet.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të provave materiale, dhe dëgjimit të CD të bashkangjitur në ankesë, ku konstatohet se nënkryetari i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Bashkim Krasniqi në raport me subjektin politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese duke nxitur urrejtje ndaj këtij subjekti politik, duke shpërndarë videon e postuar nga llogaria e facebook-kut të aktivistit të subjektit të tyre ku përmendet emri i kryetarit të IRDK-së, Elbert Krasniqi aktivisti i subjektit të tyre, ku thuhet"... po hetohet edhe ministri i MAPL, ministria e Elbert Krasniqit dyshohet se në mënyrë të kundërligjshme ka shpenzuar rreth treqind mijë euro, për projektet që kanë të bëjnë me minoritetet", ku të njëjtës ja kanë vendosur mbishkrimin " Kësaj i thonë Dinjitete dhe barazi e përkushtim për komunitete".

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 14.01.2025, ndërmoi hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".*

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha, përkatësisht postimi i përdorur ndaj subjektit politik IRDK, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Në këtë rast është marrë për bazë kontekstin dhe qëllimin për të cilin është përdorur gjuha ndaj një subjekti politik në garë, faktin që deklaratat janë bërë në miting publike, audiencën, andaj sipas Panelit përdorimi i gjuhës së tillë ndaj kundërshtarëve politikë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrime përçmues ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj sipas Panelit përdorimi i kësaj gjuhe në këtë rast konsiderohet si përkeqësim i klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe njëherit mund të rrisë tensione mes subjekteve politike.

Pretendimi në përgjigje në ankesë i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), se shpërndarja e videos është bërë nga aktivisti i cili nuk është në listë zgjedhore, që për panelin ky pretendim është i pa bazuar, pasi që nënkryetari i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Bashkim Krasniqi shpërndarë videon e postuar nga llogaria e facebook-kut të aktivistit të subjektit të tyre ku përmendet emri i kryetarit të IRDK-së, Elbert Krasniqi aktivisti i subjektit të tyre, ku thuhet”... *po hetohet edhe ministri i MAPL, ministria e Elbert Krasniqit dyshohet se në mënyrë të kundërligjshme ka shpenzuar rreth treqind mijë euro, për projektet që kanë të bëjnë me minoritetet*”, ku të njëjtës ja kanë vendosur mbishkrimin “ *Kësaj i thonë Dinjitete dhe barazi e përkushtim për komunitete*”.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje si dhe faktin që shkelja nga ky subjekt është përsëritur në këtë proces zgjedhor, njëherit subjekti politikë në fjalë nuk është përfutues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të përgjigjes në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr. 197/2025 më datë 28.01.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.